**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria –Vlada-Government*

# RREGULLORE (QRK) - NR. 17/2023 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES (QRK) NR. 02/2023 PËR SHTESËN E NËPUNËSIT TË SISTEMIT SHËNDETËSOR [1]

[1] Rregullorja (QRK) - Nr.17/2023 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores (QRK) Nr. 02/2023 për Shtesën e Nëpunësit të Sistemit Shëndetësor, është miratuar në Mbledhjen e 178-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 38/178, të datës 13.12.2023.

**Qeveria e Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 30, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe nenin 8, paragrafi 4, nën-paragrafi 4.5 i Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe nenin 19, paragrafi 6, nën-paragrafi 6.2 të Rregullores Nr.09/2011 së Punës së Qeverisë,

**Nxjerr:**

**RREGULLORE (QRK) - Nr.17/2023 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES (QRK) NR. 02/2023 PËR SHTESËN E NËPUNËSIT TË SISTEMIT SHËNDETËSOR**

**Neni 1**
**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregullore është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores (QRK) nr. 02/2023 për shtesën e nëpunësit të sistemit shëndetësor.

**Neni 2**

Paragrafi 1 nenit 7 të Rregullores bazë ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

Vlera e shtesës së nëpunësit të sistemit shëndetësor caktohet pas dhënies së aprovimit formal nga Ministri përkatës i Financave, duke marrë parasysh kufizimin sipas paragrafit 2 të këtij neni.

**Neni 3**
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

__________________________________

Kryeministër i Republikës së Kosovës

13 dhjetor 2023